



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Inovacije/ Ministry of Education, Science and Innovation

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B-057
Datë: 26.05.2023

Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 8 pika 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 2/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Për ndarje të bursave për nxënës në IAAP në drejtimet deficitare dhe bursa për vajza në drejtimet teknike

1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për vitin e ri shkollor 2023-2024 ndan bursa për nxënësit e IAAP-ve për klasën e 10-të.
2. Vlera e bursës për nxënës është 50 (pesëdhjetë) euro në muaj (përveç muajt korrik dhe gusht), përkatësisht 500 (pesëqind) euro për një vit shkollor.
3. Numri i bursave është 70, në drejtimet deficitare 40 dhe për vajza në drejtimet teknike 30.
4. Në drejtimet deficitare mund të aplikojnë të gjithë nxënësit e IAAP-ve, ndërsa, për drejtimet teknike vetëm vajzat.
5. Bursa për drejtimet deficitare:
 - Zhvillues i aplikacioneve softuerike
 - Instalues elektrik
 - Veterinë
 - Mekatronikë
 - Asistent i turizmit dhe udhëtimeve
 - Përpunimi i drurit/Zdrukthëtar
 - Hortikulturë

6. Bursat për vajza në drejtimet teknike:
- Metalpunues
 - Instalues elektrik
 - Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit
 - Automekanik
 - Teknologjia e riciklimit
 - Teknik i sistemeve të TIK-ut

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë si dhe me qëllim të përkrahjes së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP), duke pas parasysh nevojat e tregut të punës, në mbështetje të kërkesave të IAAP-ve dhe stimulimit të nxënësve në drejtimet deficitare dhe vajzave në drejtimet teknike për vitin shkollor 2023-2024, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit;
2. Sekretarit të përgjithshëm,
3. Institucioneve të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP);
4. DAAP;
5. Dep. të financave dhe shërbimeve të përgjithshme;
6. Arkivit të MASHTI

